

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga Stelantis N.V. me seli në Taurusavenju 1, 2132LS Hofdorp, Holandë dhe Hon Hai Precizhn Industri Ko. Ltd me seli në Nr. 2, Zuvou St., Tuçeng Dist., Nju Tajpei Citi, Tajvan, Republika e Kinës nëpërmjet Bozhidar Millosheviç, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 11.01.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet formimit të një sipërmarrjeje të përbashkët plotësisht funksionale nga Stelantis N.V. me seli në Taurusavenju 1, 2132LS Hofdorp, Holandë dhe Hon Hai Precizhn Industri Ko. Ltd me seli në Nr. 2, Zuvou St., Tuçeng Dist., Nju Tajpei Citi, Tajvan, Republika e Kinës, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 18.11.2022, e plotësuar 12.12.2022, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) është dorëzuar një njoftim i përqendrimit me të cilin shoqëria Stelantis N.V. me seli në Taurusavenju 1, 2132LS Hofdorp, Holandë dhe Hon Hai Precizhn Industri Ko. Ltd me seli në Nr. 2, Zuvou St., Tuçeng Dist., Nju Tajpei Citi, Tajvan, Republika e Kinës, do të formojë një sipërmarrje të përbashkët plotësisht funksionale. sipërmarrja e përbashkët plotësisht funksionale do të jetë kryesisht aktive në

projektimin dhe furnizimin e gjysmëpërçuesve për industrinë e automobilave. Pas transaksionit të propozuar, Stelantis N.V. dhe Hon Hai Precizhn Industri Ko., Ltd do të zotërojnë secili 50% të pjesës në sipërmarrjen e përbashkët, mbi të cilën do të kenë kontroll të përbashkët.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Stelantis N.V. është subjekti që e ka lindur si rezultat i përqendrimit midis Pezho S.A. dhe Fiat Krajsler Automobils N.V. dhe është shoqëria udhëheqëse e Grupit të Shoqërive Stelantis („Grupi Stelantis“). Grupi Stelantis është një grup global automobilistik aktiv në projektimin, inxhinierinë, prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e makinave, pjesëve dhe sistemeve për prodhimin e makinave në mbarë botën.

Grupi Stelantis nuk ka subjekte të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe gjeneron të ardhura në mënyrë indirekte, kryesisht nga shitja e automjeteve të saj përmes distributorëve të pavarur.

Hon Hai është një shoqëri nga Tajvani, aksionet e së cilës janë të listuar në bursën e Tajvanit. Hon Hai është shoqëri udhëheqëse e Grupit të Shoqërive Fokson. Hon Hai është ofruesi kryesor i zgjidhjeve teknologjike.

Produktet dhe shërbimet e saj kategorizohen si më poshtë:

- pjesët duke përfshirë priza të ndryshme, montime kabllore, përbërje të kabllave dhe komponentët elektronikë dhe të tjerë;
- modulet e përbëra nga pllaka amë dhe nën montime; dhe ,
- sisteme të përbëra nga një montim i plotë i sistemit të produkteve elektronike.

Grupi Fokson nuk është aktiv dhe nuk gjeneron të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски